

## **Dyzet Hadithe nga Ehl ul-Bejti për Muajin e Ramazanit**

Edin Q. Lohja  
29 Shtator 2006

Pejgamberi i Bekuar (salallahu ‘alejhi we alihi we’s-selem) ka thënë: “Kushdo nga ummeti im që memorizon dyzet hadithe mbi çështjet fetare që ka nevojë, Allahu do ta ringjallë në Ditën e Kijametit si jurist (fekih) e dijetar (‘alim).” (Muhammed Bakir el-Mexhlisi, Bihar ul-enwar, vëll. II, f. 156)

*Hadithi nr 1*

### **Përse emri Ramazan?**

I Dërguari i Allahut (s) ka thënë:

*“Pa dyshim, muaji i Ramazanit është quajtur ashtu sepse djeg mëkatet.”*  
(Kenz ul-‘Ummal, nr. 23688)

*Hadithi nr 2*

### **Emri i Zotit**

Imam Sadiku (‘a) ka thënë:

*“Mos thoni, ‘ky është Ramazani’ dhe ‘Ramazani kaloi’ apo ‘Ramazani erdhi’, pasi vërtet, Ramazan është një nga emrat e Allahut Fuqiptotë e të Lavdishëm, i Cili as nuk vjen e as nuk ikën. S’ka dyshim se vjen dhe ikën ajo që është krijesë. Përkundrazi, thoni: muaji i Ramazanit.”*

(Muhammed ibn Ja’kub el-Kulejji, el-Kafi, vëll. IV, f. 70)

*Hadithi nr 3*

### **Muaji i Shpalljes së Kur’anit**

Imam Ridai (‘a) ka thënë:

*“Nëse pyetet, ‘përse është bërë agjërimi i obligueshëm në muajin e Ramazanit e jo në muajt e tjerë?’ përgjigja është, ‘sepse muaji i Ramazanit është muaji në të cilin Allahu i Lartësuar shpalli Kur’anin’.”*

(el-Mexhlisi, vëll. XVIII, f. 190)

*Hadithi Nr 4*

### **Shpërblimi për Recitimin e Kur’anit**

Imam Ridai (‘a) ka thënë:

*“Ai që reciton një ajet nga Libri i Allahut Fuqiptotë dhe të Lavdishëm në muajin e Ramazanit është si ai që e ka lexuar krejt Kur’anin në muajt e tjerë.”*

(el-Mexhlisi, vëll. XCIII, f. 344)

*Hadithi nr 5*

### **Shpërblimi i Muajit të Ramazanit**

E pyetën Pejgamberin e Shenjtë (s):

*“O i Dërguari i Allahut! Cili prej muajve ka shpërblim më të madh, muaji i Rexhebit apo muaji i Ramazanit?”* Pejgamberi i Shenjtë (s) u përgjigj: *“Asgjë nuk mund të krahasohet me muajin e Ramazanit për nga shpërblimi.”*

(el-Mexhlisi, vëll. XCVII, f. 49)

*Hadithi nr 6*

### **Muaji i Allahut**

Pejgamberi i Bekuar (s) ka thënë:

*“Sha‘bani është muaji im, kurse Ramazani është muaji i Allahut të Lartë dhe pranvera e të varfërve.”*

(el-Mexhlisi, vëll. XCVIII, f. 68)

*Hadithi nr 7*

### **Muaji i Zgjedhur**

Pejgamberi i Bekuar (s) ka thënë:

*“S’ka dyshim se Allahu Fuqiptotë dhe i Lavdishëm ka zgjedhur ndër muaj Rexhebin, Sha‘banin dhe muajin e Ramazanit.”*

(el-Mexhlisi, vëll. XXVII, f. 53)

*Hadithi nr 8*

### **Muaji i Madh**

Pejgamberi i Bekuar (s) ka thënë:

*“Vërtet, muaji i Ramazanit është një muaj i madh. Gjatë tij, Allahu shumëfishon veprat e mira, fshin mëkatet dhe e lartëson atë në rangje.”*

(Shejh el-Hurr el-‘Amili, Wesa’il ush-Shi‘a, vëll. X, f. 132)

*Hadithi nr 9*

### **Më i Rëndësishmi i Muajve**

Imam ‘Aliu (‘a) ka thënë:

*“Ju erdhi muaji i Ramazanit. Ai është më i rëndësishmi i të gjithë muajve dhe fillimi i vitit.”*

(el-Mexhlisi, vëll. XLII, f. 193)

*Hadithi nr 10*

### **Fillimi i Vitit**

Imam Sadiku (‘a) ka thënë:

*“Nëse muaji i Ramadanit është i sigurt dhe i shëndetshëm (nga mëkatet), (i tërë) viti do të mbetet i tillë; muaji i Ramazanit është fillimi i vitit.”*

(el-‘Amili, vëll. X, f. 311)

*Hadithi nr 11*

**Muaji i Mëshirës**

Pejgamberi i Bekuar (s) ka thënë:

*“Ai është muaji, fillimi i të cilit është mëshirë, mesi i të cilit është falje dhe fundi i të cilit është mbrojtje nga Zjarri.”*

(el-Mexhlisi, vëll. XCIII, f. 343)

*Hadithi nr 12*

**Merita e Muajit të Ramazanit**

Pejgamberi i Bekuar (s) ka thënë:

*“O njerëz! Vërtet, ju erdhi muaji i Allahut. Muaji që, në sytë e Allahut është më i shkëlqyeshmi i tërë muajve. Ditët e tij janë më të mirat ditë, netët e tij janë më të mira netë dhe çastet e tij më të mirat çaste.”*

(el-Mexhlisi, vëll. XCVI, f. 356)

*Hadithi nr 13*

**Më i Miri Muaj**

Imam Sadiku (‘a) ka thënë:

*“Muaji më i mirë është muaji i Allahut - muaji i Ramazanit - dhe zemra e muajit të Ramazanit është Nata e Kadrit.”*

(el-Mexhlisi, vëll. XCVI, f. 386)

*Hadithi nr 14*

**Nata e Kadrit**

Pejgamberi i Bekuar (s) ka thënë:

*“O njerëz. Vërtet, një muaj i madh e i bekuar ju ka mbështjellë. Një muaj, në të cilën është një natë, veprat e së cilës janë më të mira se ato të njëmijë muajve.”*

(el-Mexhlisi, vëll. XCVI, f. 342)

*Hadithi nr 15*

**Dhuntia e Muajit të Allahut**

Pejgamberi i Bekuar (s) ka thënë:

*“Frymëmarrja juaj në të është madhërim (i Allahut) dhe gjumi juaj në të është adhurim (i Allahut).”*

(el-Mexhlisi, vëll. XCVI, f. 356)

*Hadithi nr 16*

**Agjërimet e Muajit të Ramazanit**

Pejgamberi i Bekuar (s) ka thënë:

*“Muaji i Ramazanit është muaji në të cilin Allahu, Fuqiplotë e i Lavdishëm, jua ka bërë obligim agjërimin. Ndaj, ai që agjëron në këtë muaj në gjendje besimi dhe me synim shlyerjen, do të pastrohet nga mëkatet ashtu siç ishte në ditën kur e lindi e ëma.”*  
(Shejh Muhammed et-Tusi, Tahdhib ul-Ahkam, vëll. IV, f. 152)

*Hadithi nr 17*

### **Muaji i Përppjekjes Shpirtërore**

Në testamentin e tij për të bijtë, Imam Sadiku (‘a) tha:

*“Kur të vijë muaji i Ramazanit, bëni përppjekje (xhihad), sepse vërtet, në këtë muaj ndahet riziku, caktohet çasti i vdekjes dhe vendoset ardhja e Haxhxit. Në të ka një natë, ku veprat janë më të mira se ato të njëmijë muajve.”*  
(el-Kulejni, vëll. IV, f. 66)

*Hadithi Nr 18*

### **Muaji i Veprave të Mira**

Pejgamberi i Bekuar (s) ka thënë:

*“Ky muaj i juaji nuk është si të tjerët. S’ka dyshim se kur afrohet, ju sjell bekime e mëshirë dhe kur largohet, jua merr mëkatet. Ky është një muaj në të cilin veprat e mira shumëfishohen dhe mirësia pranohet.”*  
(el-‘Amili, vëll. X, f. 312)

*Hadithi nr 19*

### **Muaji i Bekuar**

Pejgamberi i Bekuar (s) ka thënë:

*“Vërtet, ju erdhi muaji i Ramazanit, muaji i bekuar, në të cilin Allahu jua ka obliguar agjërimet. Në të, dyert e Xhennetit janë të hapura e shejtanët janë të lidhur; dhe në të është Nata e Kadrit, që është më e virtytshme se njëmijë muaj.”*  
(et-Tusi, vëll. IV, f. 152)

*Hadithi nr 20*

### **Muaji i Ramazanit dhe istighfari**

Imam ‘Aliu (‘a) ka thënë:

*“Është detyrë për ju të kërkoni falje dhe të përgjëroheni në muajin e Ramazanit. Du‘atë janë ato që jua largojnë fatkeqësitë, kurse istighfari jua fshin mëkatet.”*  
(el-Kulejni, vëll. IV, f. 88)

*Hadithi nr 21*

### **Dyert e Xhennetit**

Pejgamberi i Bekuar (s) ka thënë:

*“Në të (muajin e Ramazanit) dyert e Xhehenemit janë të mbyllura dhe dyert e Xhennetit janë të hapura.”*  
(el-Mexhlisi, vëll. XCVI, f. 363)

*Hadithi nr 22*

### **I'tikafi**

Imam Sadiku ('a) ka thënë:

*“Në fillim, Pejgamberi i Shenjtë (s) bënte i'tikaf gjatë dhjetë ditëve të para të muajit të Ramazanit. Pastaj, ai bënte i'tikaf gjatë dhjetë ditëve të mesit dhe atëherë nisi ta bënte në dhjetëditëshin e fundit (deri në mbyllje të jetës së tij tokësore).*

(el-Mexhlisi, vëll. XVI, f. 274)

*Hadithi nr 23*

### **Muaji i Ramazanit dhe Librat Hyjnorë**

Imam Sadiku ('a) ka thënë:

*“Teurati është shpallur në ditën e gjashtë të muajit, Bibla në natën e dymbëdhjetë, Psalmet në natën e tetëmbëdhjetë kurse Kur'ani në Natën e Kadrit.”*

(el-Kulejni, vëll. IV, f. 157)

*Hadithi nr 24*

### **Vepra më e Mirë e Muajit të Ramazanit**

Imam 'Aliu tregon se gjatë një ligjërata të Pejgamberit të Bekuar (s) ai u ngrit dhe e pyeti:

*“O i Dërguari i Allahut! Cila është vepra më e mirë në këtë muaj?” Pejgamberi i Bekuar (s) iu përgjigj: “O Ebu'l-Hasan! Vepra më e mirë për këtë muaj është të përmbajturit nga ajo që ka ndaluar Allahu Fuqplotë e i Lavdishëm.”*

(el-Mexhlisi, vëll. XLII, f. 190)

*Hadithi nr 25*

### **Humbësit e Muajit të Ramazanit**

Pejgamberi i Bekuar (s) ka thënë:

*“Atë që e jeton muajin e Ramazanit dhe nuk mëshirohet gjatë tij, Allahu e largon prej Vetes.”*

(el-Mexhlisi, vëll. LXXIV, f. 74)

*Hadithi nr 26*

### **Imam Sexhxhadi ('a) dhe Muaji i Ramazanit**

Imam Sadiku ('a) ka thënë:

*“Me të ardhur muaji i Ramazanit, Imam 'Ali ibn Huseini ('a) nuk fliste ndryshe veçse përmes du'ave, tesbiheve, istighfarit dhe tekbirit.”*

(el-Kulejni, vëll. IV, f. 88)

*Hadithi nr 27*

### **Të Premtet e Muajit të Ramazanit**

Imam Bakiri ka thënë:

*“Pa dyshim, xhumatë e muajit të Ramazanit kanë meritë mbi xhumatë e muajve të tjerë, ashtu siç ka meritë Pejgamberi i Shenjtë (s) mbi profetët e tjerë.”*

(el-Mexhlisi, vëll. LXIX, f. 376)

*Hadithi nr 28*

### **Shtatë Virtyte të Agjërimit**

Pejgamberi i Bekuar (s) ka thënë:

*“ Nuk ka besimtar, që agjëron një ditë të muajit të Ramazanit - me nijet arritjen e shpërblimeve të tij - e që Allahu i Lartësuar të mos i japë shtatë shkëlqyeshmëri: 1. Ushqimi i ndaluar që i ka hyrë në trup i shkrihet. 2. I afrohet më pranë mëshirës së Allahut. 3. Allahu ia lan gjynahet. 4. Allahu ia pakëson vuajtjet e vdekjes. 5. Allahu e mbron nga uria dhe etja në Ditën e Gjykimit. 6. Falet nga dënimi i Skëterrës. 7. Allahu i siguron ushqimin e mirë dhe të shijshëm të Xhenetit.”*

(el-‘Amili, vëll. VII, f. 395)

*Hadithi nr 29*

### **Muaji i Durimit**

Pejgamberi i Bekuar (s) ka thënë:

*“Ai është muaji i durimit, dhe s’ka dyshim se shpërblimi i durimit është Parajsja.”*

(el-Kulejni, vëll. 4, f. 66)

*Hadithi nr 30*

### **Dhënia e Sadakasë**

Imam Sadiku (‘a) ka thënë:

*“Allahu do t’ia largojë shtatëdhjetë lloje fatkeqësish atij që jep sadaka në muajin e Ramazanit.”*

(el-‘Amili, vëll. IX, f. 404)

*Hadithi nr 31*

### **Shpërblimi për një Obligim**

Pejgamberi i Bekuar (s) ka thënë:

*“Ai që kryen (në të) një obligim të vetëm nga obligimet e Allahut, do të shpërblehet si ai që ka kryer shtatëdhjetë obligime në muajt e tjerë.”*

(el-‘Amili, vëll. X, f. 307)

*Hadith nr 32*

### **Nata e Kadrit**

Imam Bakiri (‘a) ka thënë:

*“Natën e Kadrit vendoset gjithçka - e mira dhe e keqja, bindja dhe mosbindja, lindja dhe vdekja, si dhe rizku - që do të ndodhë gjatë atij viti, deri në Natën tjetër të Kadrit.”*

(el-Kulejni, vëll. IV, f. 157)

*Hadithi nr 33*

### **Shtojini Namazet në Muajin e Ramazanit**

Imam Sadiku (‘a) ka thënë:

*“Me të ardhur muaji i Ramazanit, i Dërguari i Allahut (s) i shtonte namazet; edhe unë i shtoj të miat, ndaj shtojini edhe ju tuajat.”*

(et-Tusi, vëll. III, f. 60)

*Hadithi nr 34*

### **Ngrënia e Syfyrit**

Pejgamberi i Bekuar (s) ka thënë:

*“Hajeni syfyryn edhe nëse është disa gllënka ujë, sepse bekimet e Allahut janë mbi ata që hanë syfyr.”*

(et-Tusi, vëll. IV, f. 198)

*Hadithi nr 35*

### **Uria dhe Etja e Ditës së Kijametit**

Imam ‘Aliu ka thënë:

*“Le t’jua kujtojë uria dhe etja në të (muajin e Ramazanit) urinë dhe etjen e Ditës së Kijametit.”*

(el-Mexhlisi, vëll. XCIII, f. 356)

*Hadithi nr 36*

### **Thirrja e Allahut**

‘Abdullah ibn ‘Abbasi tregon se ai e kishte dëgjuar Pejgamberin e Bekuar (s) duke thënë:

*“Çdo natë në muajin e Ramazanit Allahu i Madhërishëm e i Lartësuar thërret tri herë: A ka ndonjë që kërkon prej Meje, që t’ia plotësoj kërkesën? A ka ndonjë që kthehet drejt Meje me pendesë, që Unë të kthehem drejt tij (me mëshirë)? A ka ndonjë që Më kërkon falje, që Unë ta fal?”*

(el-‘Amili, Mustedrek ul-Wesa’ ail, vëll. VII, f. 429)

*Hadithi nr 37*

### **Ghusli i Natës së Kadrit**

Imam Kadhimi (‘a) ka thënë:

*“Atij që merr ghusl në Natën e Kadrit dhe rri zgjuar (në adhurim) do t’i falen të gjitha mëkatet.”*

(el-‘Amili, vëll. X, f. 358)

*Hadithi nr 38*

### **Mburoja e Besimtarit**

Në një hadith kudsî, Allahu Fuqiptotë dhe i Madhërishëm thotë:

*“Agjërimet janë mburojë për besimtarët në Ditën e Gjykimit, ashtu siç janë mburojë armët në këtë botë.”*

(el-‘Amili, vëll. X, f. 403)

*Hadithi nr 39*

### **Iftar për Besimtarin**

Pejgamberi i Bekuar (s) ka thënë:

*“Atij që i shtron iftar një besimtari në muajin e Ramazanit do t’i jepet shpërblimi i atij që ka liruar një rob (në rrugën e Allahut) dhe do t’i falen mëkatet e mëparshme. E nëse nuk ka patur më shumë se qumësht të përzier me ujë për të ofruar, ose ujë të ëmbëlsuar dhe një hurmë, Allahu prapë do ia japë shpërblimin.”*

(el-Mexhlisi, vëll. XCIII, f. 317)

*Hadithi nr 40*

### **Lamtumira Muajit të Ramazanit**

Pejgamberi i Bekuar (s) lutej:

*“O Allah! Mos e cakto këtë muaj të Ramazanit të jetë i fundit për agjërimet e mia. Por nëse e cakton, atëherë bekomë dhe mos më privo (nga mëshira Jote).”*

(Badabi el-Kur’an, f. 398)